



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.12.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Termovizion" për aktivitetin: **"Mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në Shkollat dhe institucioneve tjera Komunale"** me Nr. të Prok: 616 21 150 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Termovizioni" e datës 30.12.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit" **Mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në Shkollat dhe institucioneve tjera Komunale"** me Nr. të Prok: 616 21 150 211 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 25.11.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 25.11.2021 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Termovizion" me datë 30.11.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' " **Mirëmbajtën e ngrohjes qendrore ne Shkollat dhe institucioneve tjera Komunale**" me Nr. të Prok: 616 21 150 111 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 02.12.2021, ka shqyrtuar kërkesës në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- Pretendimi i parë është plotësisht i pa bazuar pasi që respektimi i kundërvlerës për paranë nënkupton rastet për tenderuesit e përgjegjshëm e jo për tenderues të pa përgjegjshëm;
- Pretendimi i dytë pothuajse është i njëjtë me pretendimin paraprak dhe shfrytëzimi efikas dhe efektiv i parasë publike si në të gjitha rastet nënkupton vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm sipas këtij parimi e jo tenderët e konsideruar si të pa përgjegjshëm;
- Pretendimi i tretë poashtu është i pa bazuar, pasi që nuk ka asnjë diskriminim për asnjë tenderues sepse kërkesat për sqarime janë dërguar për të gjithë tenderusit dhe sqarimet e tyre janë trajtuar nga komisioni profesional i Komunës, i cila ka marrë për bazë dëshmitë e ofruara e jo dijen që e kanë të njëjtit për gjendjen e paisjeve të ngrohjes në Komunë;
- Poashtu pretendimi për shkeljen e nenit 59 është i pa qëndrueshëm, pasi që komisioni profesional ka pasë dyshim të bazuar për disa çmime jonormalisht të ulta e për të cilat jo vetëm se nuk keni dhenë dëshmi konkrete, por përkundrazi keni ofruar dëshmi se çmimit e furnizimit janë dukshëm më të larta se sa çmimi i dhenë në ofertën tuaj, ndërsa aprovimi i sqarimeve të tenderuesit tjetër është bërë nga komisioni duke marrë për bazë se për shumicën e kërkesave tona për sqarim i njëjti ka dhenë sqarime të mjaftueshme;
- Pretendimi i fundit lidhur me mosrespektim të nenit 60-Kriteri për dhënjen e tenderit për tenderuesin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët është poashtu i pa bazuar pasi që kemi të bëjmë me tenderin e trajtuar si të pa përgjegjshëm, të cilin vetë formulimi i kriterit e përjashton.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit